



Universiteti i Prizrenit	
University of Prizren	
Univerzitet Prizrena	
"UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	30.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protekolit
308	01-492



**UNIVERSITETI – UNIVERSITY  
“UKSHIN HOTI” PRIZREN**

**BIBLIOTEKA PRIZREN**

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Ndërmjet**

**UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” PRIZREN**

**dhe**

**BIBLIOTEKËS SË PRIZRENIT**

**Neni 1**

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejmë Marrëveshje) lidhet mes Bibliotekës së Prizrenit, e përfaqësuar nga Drejtoresha Znj. Sadete Sadikaj- Kukaj dhe Universitetit “Ukshin HOTI” Prizren, përfaqësuar nga rektori Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj.

**Neni 2**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

**Neni 3**

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngrenë nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes të tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm edukativ, social dhe ekonomik, dhe ngritjen profesionale të studentëve të Universitetit.

**Neni 4**

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren së bashku do të kontribuojnë në drejtimin të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit ë sektorit edukativ dhe profesional, shërbimeve të bibliotekave përkatëse për këtë Universitet, trajnimi i stafit dhe shkëmbimi i përvojës në biblioteka.

**Neni 5**

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me promovimin e kulturës dhe në mënyrë të rregullt të këmbejnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve të përbashkëta si në Biblioteka edhe në fusha të tjera të kulturës.

**Neni 6**

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen të ndihmojnë në furnizimin e ndërsjellë të bibliotekave përkatëse me literaturë shkencore e profesionale të botuara në Universitetin dhe Bibliotekën e Prizrenit.

Neni 7

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen që për nevoja të tyre të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Neni 8

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen që të bashkëpunojnë në organizimin e përbashkët të Javës së Bibliotekave dhe aktivitete të ngashme kulturore.

Neni 9

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen për Shfrytëzimin e hapësirave infrastrukturore, sallave për mësim, amfiteatreve etj., për realizimin e projekteve të caktuara në interes të përgjithshëm.

Neni 10

Biblioteka Prizrenit dhe Universiteti “Ukshin HOTI” Prizren pajtohen që të bashkëpunojnë gjate procesit të hartimit të programeve të bibliotekave si dhe programeve të caktuara studimore në kuadër të Universitetit.

Neni 11

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhe pesëvjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi, plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.

Neni 12


Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruuese.

**Përfaqësuar nga:**


**Rektor:**

**Prof. Asoc. Dr. Ismet TEMAJ**



**Drejtoresha e Bibliotekës:**

**Znj. Sadete Sadikaj - Kukaj**



Prizren, Dhjetor 2019